

[Data 29.12.2022]

PROCESVERBAL- Tipi i kontratës - Shërbime

PËR ARGUMENTIMIN DHE MIRATIMIN E SPECIFIKIMEVE TEKNIKE DHE KRITEREVE PËR KUALIFIKIM

(Ky procesverbal është për efekt publikimi bashkë me dokumentet e tenderit)

OBJEKTI I PROCEDURËS: “Sistemi elektronik për të ruajtur , menaxhuar dhe ndjekur në formë elektronike informacionin e bazuar në dokumenta zyrtarë(letër)”.

KODI PËRKATËS NË FJALORIN E PËRBASHKËT TË PROKURIMIT (CPV): Shërbim programimi per aplikacione 72212000-4

Vlera e Fondit Limit: 29,166,665 (njëzet e nënëtë milion e njëqind e gjashtëdhjetë e gjashtë mijë e gjashtëqind e gjashtëdhjetë e pesë) lek pa tvsh, i përbërë nga dy vlera që u përkasin dy llogarive të ndryshme, respektivisht llogarisë për investime dhe asaj për shpenzime korrente, si më poshtë vijon:

- Sistemi elektronik për të ruajtur, menaxhuar dhe ndjekur në formë elektronike informacionin e bazuar në dokumenta zyrtarë(letër)” në programin buxhetor “Investim (231)” me vlerë të fondit limit 25.000.000 (njëzetë e pesë milion) lekë pa tvsh
- Sistemi elektronik për të ruajtur, menaxhuar dhe ndjekur në formë elektronike informacionin e bazuar në dokumenta zyrtarë(letër)” në programin buxhetor “Shpenzime operative (602)” me tipologji (mirëmbajtje dhe trajnime) me vlerë të fondit limit 4.165.665 (katër milion e njëqind e gjashtëdhjetë e pesë mijë e gjashtëqind e gjashtëdhjetë e pesë) lekë pa tvsh.
- *Shënim: Referuar rekomandimit nr. 6911 prot., datë 28.10.2020 të APP-së, vlerat e ofertës ekonomike të investimit dhe të mirëmbajtjes të ofruara nga operatorët ekonomikë nuk duhet të tejkalojnë vlerën e fondit limit të parashikuar në njoftimin e kontratës për këto zëra (investim edhe mirëmbajtje), pasi në të kundërt oferta do të konsiderohet si ofertë e dhënë mbi fond limit dhe si e tillë, nuk mund të kualifikohet.*

Në bazë të nenit 21, pika 2, të Ligjit nr.162/2020 “Për prokurimin publik”, nenit 2, pika 2/c dhe nenit 78, pika 2, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, autoriteti kontraktor Bashkia Tiranë ka hartuar procesverbalin për argumentimin dhe miratimin e specifikimeve teknike dhe kriterëve për kualifikim për procedurën e sipërcituar, me përmbajtjen si më poshtë:

I. KRITERET E VEÇANTA TË KUALIFIKIMIT

1. Ofertuesi duhet të paraqesë:

a. *Formularin Përmbledhës të Vetëdeklarimit, sipas shtojcës 9*

b. Sigurimin e Ofertës, sipas Shtojcës 3;

c. Formularin e Ofertës, sipas Shtojcës 1

d. Lista e çmimeve të shërbimeve sipas Shtojcës 2

Kriteret e mesiperme janë vendosur në përputhje me Nenin 82 “Formulari përmbledhës i vetdeklarimit” dhe Neni 83 “Sigurimi i ofertës”, të Ligjit Nr.162/2020 “Për Prokurimin Publik” si dhe në mbështetje të nenit 30, pika 1, të VKM-së Nr.285, datë 19.5.2021 “Për Miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik: citojme Neni 83 i LPP “Autoriteti kontraktor duhet të kërkojë paraqitjen e sigurimit të ofertës nga ofertuesit në të gjitha llojet e procedurave të prokurimit, me përjashtim të procedurave të prokurimit me vlerë të vogël”, Neni 82, i LPP “1. Bashkë me dorëzimin e kërkesave për pjesëmarrje ose të ofertave, autoritetet ose entet kontraktore pranojnë si prova paraprake në vend të disa vërtetimeve të leshuara nga autoritetet publike ose pale të treta, formularin përmbledhës të vetdeklarimit, sipas parashikimeve të këtij ligji. Përmbajtja e këtij formulari përcaktohet në rregullat e prokurimit publik”.

2. Kandidati/Ofertuesi duhet të dorëzojë:

2.1. Përshatshmëria për të kryer veprimtarinë profesionale:

Referuar pikës 1 të shtojcës 8, ofertuesi duhet të deklarojë se përmbush kriteret e përgjithshme të pranimit/kualifikimit. Këto kritere duhet të plotësohen me dorëzimin e vetdeklaratës me shkrim të subjektit, në ditën e hapjes së ofertës, sipas Shtojcës 9.

Argumentimi: Kërkesa e mësipërme bazohet në nenin 77, pika 1/a dhe 2, të LPP, nenit 41, pika 5, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, si dhe shtojcës 8 të DST-së.

2.2. Kapaciteti ekonomik dhe financiar:

2.2.1 Për të provuar kapacitetet financiare dhe ekonomike, operatorët ekonomikë duhet të paraqesin vërtetim për xhiron vjetore për vitet financiare 2019, 2020, 2021 ku vlera e xhiros për të paktën një nga vitet e periudhës së kërkuar duhet të jetë jo më e vogël se vlera e fondit limit që prokurohet. Kërkesa për plotësimin e kapaciteteve financiare konsiderohet e përmbushur nëse operatorët ekonomikë arrijnë vlerën e xhiros minimale, në të paktën një vit të periudhës së kërkuar nga autoriteti/enti kontraktor.

Argumentimi: Kërkesa e mësipërme është përcaktuar bazuar në vlerën e fondit limit të kësaj procedure, si dhe nenin 77, pika 3, të LPP, si dhe nenin 43, pika 2/c, 55/4 të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”.

Përcaktimi i vlerës së kërkuar argumentohet si më poshtë: “Vlera e xhiros minimale vjetore që u kërkohet operatorëve ekonomikë nuk mund të tejkalojë:

.... vlerën e parashikuar të kontratës, në procedurat e prokurimit mbi kufirin e ulët monetar dhe nën kufirin e lartë monetar”. Kjo procedurë është mbi kufirin e ulët monetar dhe nën kufirin e lartë monetar dhe për këtë arsye, vlera e xhiros minimale të kërkuar, është brenda kufirit të parashikuar në dispozitat ligjore të sipërcituara.

Përcaktimi i viteve të kërkuara për paraqitjen e vërtetimit të xhiros vjetore është bërë bazuar në nenin 43, pika 2/c, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, si dhe në legjislacionin e fushës në fuqi, përkatësisht në Ligjin nr. 8438, datë 28.12.1998 “Për tatimin mbi të ardhurat”, i ndryshuar, VKM nr. 922 datë 29.12.2014 “Për deklarimin e detyrueshëm të deklaratave tatimore dhe të dokumenteve të tjera tatimore, vetëm nëpërmjet formës elektronike”, si dhe në Udhëzimin e Ministrit të Financave nr.5, datë 30.01.2006, “Për tatimin mbi të ardhurat”, i ndryshuar.

2.2.2 Vetëdeklarim për shlyerjen e taksave vendore të parashikuara nga Pushteti Vendor për vitin 2022, ku të përfshihet kësti për periudhën përkatëse të maturuar sipas Ligjit Nr.9632 datë 30.10.2006 “Për sistemin e taksave vendore”, i ndryshuar, nëpërmjet paraqitjes së formularit përmbledhës të vetëdeklarimit, sipas shtojcës 9. (Në çdo rast AK ka të drejtë të kryejë verifikimet e nevojshme mbi vërtetësinë e informacionit të deklaruar nga operatori ekonomik ose ti kërkojë operatorit ekonomik sqarime dhe dokumente mbështetëse për këto sqarime.

Argumentimi: Kërkesa e mësipërme është përcaktuar në nenin 77, pika 3, e Ligjit nr. 162, date 23.12.2020 “Për prokurimin publik”, nenin 43, pika 6 e VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”(i ndryshuar), si dhe ligjin nr. 9920 datë 19.05.2008 “Për procedurat tatimore” (i ndryshuar), neni 4, pika 2, gërma d) dhe në ligjin nr. 9632, datë 30.10.2006 “Për Sistemin e Taksave Vendore” (i ndryshuar).

Ky kriter shërben për të garantuar AK se operatorët ekonomikë pjesëmarrës në këtë procedurë prokurimi, kanë kapacitetet e duhura ekonomike dhe financiare si dhe janë të përshtatshëm për të kryer veprimtari profesionale.

Referuar sa më sipër, Autoriteti Kontraktor gjykon se kriteri i vendosur lidhur me dorëzimin nga ana e operatorëve ekonomikë të deklaratës për shlyerjen e detyrimeve vendore për vitin 2022 sipas kësteve pranë bashkisë/ve ku operatori ekonomik ushtron aktivitetin e tij është në përputhje me kuadrin ligjor në fuqi e konkretisht me ligjin nr. 9632, datë 30.10.2006 për “Sistemin e Taksave Vendore” i ndryshuar.

2.3. Kapaciteti teknik:

2.3.1 Për të provuar përvojën e mëparshme, Operatori ekonomik duhet të paraqesë dëshmi për realizimin me sukses të një ose disa kontratave të mëparshme, të ngjashme, të kryera gjatë tre viteve të fundit. Në çdo rast, vlera e kërkuar duhet të jetë në një vlerë jo më të vogël se 40 % të vlerës së përllogaritur të kontratës që prokurohet dhe që është realizuar gjatë tre viteve të fundit, nga data e shpalljes së njoftimit të kontratës.

Për të vërtetuar përvojën e mëparshme të ngjashme, operatorët ekonomikë duhet të paraqesin dëshmitë e mëposhtme:

a) Si dëshmi për përvojën e mëparshme të realizuar me sektorin publik, operatori ekonomik duhet të paraqesë vërtetime të lëshuara nga enti publik për përmbushjen me sukses të kontratës, ku të shënohen vlera, afati i përfundimit të kontratës dhe fatura tatimore të shitjes, të plotësuara sipas kërkesave të legjislacionit në fuqi, ku shënohen datat, shumat dhe shërbimet/furnizimet e realizuara.

b) Në rastin e përvojës së mëparshme të realizuar me sektorin privat, si dëshmi pranohen vetëm fatura tatimore të shitjes, të plotësuara sipas kërkesave të legjislacionit në fuqi, dhe të deklaruara në organet tatimore, ku shënohen datat, shumat dhe shërbimet/furnizimet e realizuara.

Argumentimi: Kërkesa e mësipërme është përcaktuar bazuar në nenin 77 të ligjit nr. 162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik” dhe nenit 41, pika 3 të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik”(i ndryshuar). Me anë të këtij kriteri kërkohet që operatorët ekonomikë të dëshmojnë që kanë përvojën e nevojshme për të zbatuar kontratën. Kriteri garanton autoritetin kontraktor se operatorët ekonomikë pjesëmarrës, kanë realizuar kontrata të ngjashme me ente publike apo me sektorin privat dhe i kanë përmbushur detyrimet e parashikuara në kontratë. Vlera jo më pak se 40% e vlerës së përlllogaritur të kontratës, është në përputhje me dispozitat ligjore.

2.3.2 Operatori ekonomik duhet të jetë i certifikuar me:

- a) Standartin ISO 9001 ose ekuivalent për sistemin e menaxhimit të cilësisë, objekt i të cilës të jetë në përputhje me objektin e prokurimit (e vlefshme) dhe të lëshuara nga një organ i vlerësimit të konformitetit, i akredituar nga organizmi kombëtar i akreditimit ose organizma ndërkombëtarë akreditues, të njohur nga Republika e Shqipërisë.
- b) Standartin ISO 27001 ose ekuivalente për sistemin e menaxhimit të sigurisë së informacionit, objekt i së cilës të jetë në përputhje me objektin e prokurimit (e vlefshme, dhe të lëshuara nga një organ i vlerësimit të konformitetit, i akredituar nga organizmi kombëtar i akreditimit ose organizma ndërkombëtarë akreditues, të njohur nga Republika e Shqipërisë).
- c) Operatori ekonomik duhet të jetë i certifikuar me standartin ISO 20000-1 ose ekuivalente për sistemin e menaxhimit të shërbimit, objekt i së cilës të jetë në përputhje me objektin e prokurimit (e vlefshme, dhe të lëshuara nga një organ i vlerësimit të konformitetit, i akredituar nga organizmi kombëtar i akreditimit ose organizma ndërkombëtarë akreditues, të njohur nga Republika e Shqipërisë)

Në rastet e Bashkimit të Operatorëve ekonomik, çdo anëtar i grupit duhet të paraqesë Çertifikatën ISO sipas zërave që do të marrë përsipër të realizojë referuar akt-marrëveshjes.

Argumentimi:

Kërkesat e mësipërme janë përcaktuar në mbështetje të nenit 77, pika 4 të ligjit nr. 162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik”,

...“Në lidhje me aftësitë teknike dhe profesionale, autoritetet ose entet kontraktore mund të vendosin kërkesa që garantojnë se operatorët ekonomikë zotërojnë burimet e nevojshme

njerëzore e teknike, si dhe përvojën e nevojshme për të zbatuar kontratën sipas një standardi të përshtatshëm cilësie...”

Si dhe mbështetur në nenin 44, pika 1 të VKM nr.285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik” (i ndryshuar) konkretisht:

... *“Autoriteti/enti kontraktor, për të vërtetuar se punët, mallrat ose shërbimet, objekt prokurimi, i plotësojnë kërkesat e cilësisë, mund t’u kërkojë ofertuesve të paraqesin certifikata të lëshuara nga një organ i vlerësimit të konformitetit, i akredituar nga organizmi kombëtar i akreditimit ose organizma ndërkombëtarë akreditues, të njohur nga Republika e Shqipërisë, vetëm nëse ato janë të argumentuara dhe të lidhura ngushtësisht dhe në mënyrë të drejtpërdrejtë me objektin e prokurimit...”*

a) ISO 9001 parashikon një tërësi rregullash që garantojnë një bazë rreziku parandalues ndaj cilësisë e cila mbulon një gamë të gjerë të çështjeve ku përfshihen: angazhimi i lartë i menaxhimit për cilësi nga operatori ekonomik, fokusin e klientit, përshtatshmërinë e burimeve të tij, kompetencën/profesionalizmin e stafit, procesin e menaxhimit (për furnizim, ofrimit të shërbimeve dhe proceset mbështetëse e administrative), planifikimin e cilësisë, garantimin e një procesi cilësor të furnizimit, sigurimin e konformitetit për shërbimet, proceset e tij për të zgjidhur ankesat e klientëve, veprime korrigjuese, dhe një kërkesë për të nxitur përmirësimin. Kjo kërkesë, dëshmon se mbajtësi i saj garanton standardet ndërkombëtare të menaxhimit të cilësisë së ushtrimit të aktivitetit tregtar të tij. Kërkesa për ISO 9001 është një kërkesë e domosdoshme për të realizuar suksesin e kontratës.

b) ISO 27001 është një kuadër standartizues në lidhje me garancitë që kërkon autoriteti kontraktor nga operatorët ekonomikë në lidhje me:

- mirëmbajtjen e sistemit ISMS (Information Security Management System) brenda vetë organizatës së operatorit ekonomik.
- aplikimin e praktikave të sigurisë për menaxhimin e risqeve të sigurisë.
- aplikimin e praktikave të sigurisë për trajtimin e të dhënave sensitive.
- aplikimin e masave dhe praktikave të sigurisë për shërbimet e kryera në ambiente sensitive.

Referuar sa më sipër cituar, ky standard lidhet drejtpërdrejt me zërat e kërkuara në termat e referencës si:

“... ”

- *Shërbimi i skanimit të dokumentave ekzistues nga Operatori Ekonomik*

- *Identifikimin dhe diagnostikimin e detajuar për çdo problem apo keqfunksionim të komponentëve të sistemit apo të problemeve të sigurisë dhe të propozojë zgjidhjen përkatëse.*
- *Instalimi i sistemit dhe pajisjeve hardware në infrastrukturën e furnizuar nëpërmjet kësaj kontrate, në ambjentet përkatëse në institucion.*
- *Mirëmbajtje e sistemit për 24 (njëzetë e katër) muaj nga data e marrjes në dorëzim të sistemit...”*

Realizimi i detyrave të sipërcituara dhe jo vetëm, kërkon akses në informacione sensitive dhe tepër konfidenciale të AK, si rrjedhojë është e rëndësishme aplikimi i praktikave të sigurisë për trajtimin e këtyre të dhënave sensitive. Gjithashtu nëpërmjet kësaj kontrate kërkohet furnizimi, instalimi, konfigurimi dhe integrimi i pajisjeve Hardware dhe i sistemit objekt kontrate, në ambjentet sensitive të infrastrukturës ekzistuese të Bashkië Tiranë, si dhe mirëmbajtja e sistemit për një periudhë 24 (njëzetë e katër) muaj.

Referuar sa më sipër, disponueshmëria e certifikatës ISO 27001, parë kjo në raport me natyrën e furnizimeve dhe shërbimeve të kërkuara, ndërhyrje në infrastrukturën ekzistuese dhe trajtimin e informacionit konfidencial gjatë implementimit të saj, është një kërkesë në përpjesëtim të drejtë me natyrën dhe objektin e kontratës që prokurohet nga Autoriteti Kontraktor, dhe është një kërkesë e domosdoshme për realizimin me sukses të kontratës.

c) ISO 20000-1 është një kuadër standardizues në lidhje me garancitë që kërkon autoriteti kontraktor nga operatorët ekonomikë për: ndjekjen konsistente të shërbimeve deri në kryerjen e plotë të tyre sipas kërkesave të DST-së. Standardi ISO 20000-1 përcakton kriteret për planifikimin, krijimin, menaxhimin, monitorimin, rishikimin, mirëmbajtjen dhe përmirësimin e qasjes së menaxhimit të shërbimeve që fokusohet në teknologjitë e informacionit.

Kjo certifikatë siguron Autoritetin Kontraktor që të gjitha shërbimet IT do të menaxhohen sipas standardeve më të mira të shërbimeve të teknologjisë së informacionit.

Këto kërkesa janë në vetvete një garanci më tepër për suksesin e projektit

2.3.3 Operatori ekonomik duhet të paraqesë autorizim nga prodhuesi ose nga distributori i autorizuar për pajisjet *Server* dhe *Upgrade Hapësirë ruajtëse* të ofertuara ku të përcaktohen edhe kontaktet e prodhuesit ose të distributorit të autorizuar. Në rast se do të paraqitet autorizim nga distributori i autorizuar nga prodhuesi duhet të vërtetohet lidhja midis distributorit dhe prodhuesit. Autorizimi duhet të përmbajë të dhëna të plota të prodhuesit si: telefon/fax email, website, kjo e nevojshme për AK në rast verifikimi.

Kriteri është hartuar në përputhje me VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik, Neni 40, pika 5. Autoriteti kontraktor, duke qenë se është përfituesi direkt i kontratës objekt prokurimi, është në të drejtën e tij të garantohet se operatorët ekonomikë pjesëmarrës dëshmojnë autorizim prodhuesi ose distributori të autorizuar për mallrat e furnizuara (*server, upgrade hapësirë ruajtëse*), e rrjedhimisht mund t’u kërkojë ofertuesve të paraqesin dokumentacion përkatës. Në këtë kontekst, referuar natyrës dhe objektit të prokuruar autoriteti kontraktor me anë të kërkesës së tij për paraqitjen e autorizimit nga prodhuesi/ distributor i

autorizuar për pajisjet e ofruara, e cila është vendosur në përputhje me Specifikimet Teknike të procedurës, kërkon të garantohet për besueshmërinë, cilësinë dhe kapacitetet e operatorëve ekonomikë ofertues. Ky kriter lidhet gjithashtu me shërbimin e mirëmbajtjes dhe garancisë së pajisjeve përgjatë periudhës së kërkuar, si dhe nevojës për garanci mbi efikasitetin dhe kapacitetet teknike të tyre.

2.3.4 Operatori ekonomik duhet të paraqesë ofertë teknike për pajisjet *Infrastrukturë Hardware* ku të specifikohet marka, modeli shoqëruar me katalogë ose broshura për mallrat që oferton (Server, Upgrade Hapësirë ruajtëse, Skaner Fotografik) duke shënuar në mënyrë të qartë dhe të dallueshme secilin nga artikujt e ofruar sipas modelit të deklaruar dhe specifikimet përkatëse sipas të dhënave në DST. (Katalogu të përmbajë karakteristikat teknike të çdo artikulli që është objekt i prokurimit me qëllim që Autoriteti Kontraktor të gjykojë nëse malli i ofruar plotëson kërkesat teknike të përcaktuara në dokumentet e tenderit. Specifikimet teknike të markës dhe modelit të ofertuar do të krahasohen me katalogun e pajisjeve dhe specifikimet teknike të DST për përputhshmërinë e tyre). Fleta ose fletët e katalogut/broshurës që pasqyrojnë specifikimet teknike të kërkuara të pajisjes dhe të software duhet të paraqiten në gjuhën shqipe, të përkthyer dhe noterizuara.

Argumentimi:

Kërkesa për paraqitjen e katalogëve, jep mundësinë për kryerjen e verifikimeve për përputhshmërinë e specifikimeve teknike të pajisjeve të ofertuara, paraqitur nga operatorët ekonomikë, në rast se janë në përputhje me specifikimet teknike të hartuara nga Autoriteti Kontraktor.

2.3.5 Për të garantuar implementimin me sukses të kontratës, realizimin e investimit dhe shërbimeve përkatëse si dhe shërbimit të skanimit në periudhën e përcaktuar, si dhe për të garantuar suportin përgjatë periudhës së parashikuar të mirëmbajtjes sipas dokumentit të termave të referencës, operatori ekonomik ofertues duhet të disponojë staf të kualifikuar prej minimalisht 10 (dhjetë) punonjësish një pjesë prej të cilëve të kenë kërkesat minimale si më poshtë:

- a) Të paktën 1 (një) punonjës të certifikuar për Menaxhim Projektesh ose ekuivalente.
- b) Të paktën 1 (një) punonjës të certifikuar në PHP/Java ose ekuivalente.
- c) Të paktën 1 (një) punonjës të certifikuar për administrimin e bazës së të dhënave.
- d) Të paktën 1 (një) punonjës të certifikuar për Testim Programesh ose ekuivalente.
- e) Të paktën 1 (një) punonjës të certifikuar për konfigurimin e pajisjes *Server* të ofertuar
- f) Të paktën 1 (një) punonjës të certifikuar për konfigurimin e pajisjes *Upgrade Hapësirë ruajtëse* të ofertuar.
- g) Të paktën 1 (një) punonjës për MCSE Infrastrukture ose ekuivalente.
- h) 1 (një) punonjës, i certifikuar për ITIL ose ekuivalente.

Për të vërtetuar stafin e mësipërm operatori Ekonomik duhet të paraqesë:

1. Deklarimin nga Operatori Ekonomik të personelit teknik (emër mbiemër) dhe profilin përkatës (certifikimet respektive),;
 - Certifikata/Transkriptet përkatëse
 - Listëpagesat sipas formularit E-Sig 025/a për muajin e fundit të deklaruara sipas legjislacionit në fuqi.

Kriteri 2.3.5 do të konsiderohet i përmbushur me plotësimin e formularit sipas shtojcës 9, pjesa III, pika B të DT. Dokumentat e kërkuara më sipër do të paraqitën nga OE i kualifikuar në vend të parë përpara publikimit të njoftimit paraprak të fituesit dhe nisjes së afateve të ankimit.

Shënim: OE duhet të mbajnë në konsideratë përcaktimet ligjore, referuar Neni 26, pika 1, të VKM Nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik” i ndryshuar, ku parashikohet se, “Bashkë me dorëzimin e kërkesave për pjesëmarrje ose të ofertave, autoriteti/enti kontraktor pranon si provë paraprake, në vend të disa vërtetimeve të lëshuara nga autoritetet publike ose palë të treta, formularin përmbledhës të vetëdeklarimit, sipas përcaktimit në nenin 82, të LPP-së, dhe në këto rregulla”, si dhe përcaktimet e pikës 6, të këtij neni, në lidhje me momentin e paraqitjes së dokumentacionit dëshmuës për kërkesat që përfshihen në formularin përmbledhës të vetëdeklarimit, ku parashikohet që, “Përpara publikimit të njoftimit të fituesit dhe nisjes së afateve të ankimit, autoriteti/enti kontraktor i kërkon ofertuesit të kualifikuar, i pari dorëzimin e dokumenteve provuese të parashikuara në shkronjat “a”, “b”, “d”, “dh”, “e”, “h”, “i”, “j” të pikës 2 të këtij neni, si dhe dokumentet e tjera shoqëruese të ofertës, të dorëzuara në rrugë elektronike. Këto dokumente duhet të paraqiten në origjinal ose në kopje të njësuara me origjinalin.”.

- Mosparaqitja e dokumentacionit provues, do të jetë kusht s’kualifikimi.
- Autoriteti Kontraktor do të bëjë verifikimin e dokumentacionit në përputhje me vetëdeklarimin e bërë gjatë fazës së ofertimit. Konstatimi i mosperputhjeve midis Formularit Përmbledhës të Vetëdeklarimit dhe dokumentacionit të dorëzuar përbën kusht s’kualifikimi.

Të gjitha dokumentet duhet të jenë origjinale ose kopje të noterizuara. Rastet e mosparaqitjes së një dokumenti, ose dokumente false dhe të pasakta, konsiderohen kushte për skualifikim.

Argumentimi: Kërkesa për staf është hartuar në përputhje me VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik, Neni 41, pika 4.

Për të provuar përshtatshmërinë për të kryer veprimtarinë profesionale, kapacitetet teknike dhe profesionale, autoriteti/enti kontraktor kërkon:

- a) licenca profesionale për realizimin e shërbimeve, objekt i kontratës, të lëshuara nga autoritetet kompetente shtetërore; dhe /ose
- b) një listë të personelit kryesor, të nevojshëm për të zbatuar objektin e prokurimit dhe/ose komponentët e saj. Lista e personelit kryesor duhet të përfshijë CV-të e tyre dhe licencat profesionale, kur kanë të tilla sipas legjislacionit përkatës; dhe/ose

- c) fuqinë punëtore të operatorit ekonomik të nevojshëm për ekzekutimin e objektit të prokurimit; dhe/ose
- d) ç) mjetet dhe pajisjet teknike që ka në dispozicion apo që mund t'i vihen në dispozicion operatorit ekonomik për të përmbushur kontratën.

Argumentimi për kërkesën: Të paktën 1 (një) punonjës të certifikuar për Menaxhim Projektesh ose ekuivalente.

Një menaxher projekti është përgjegjës për ndjekjen e të gjithë ciklit të një projekti implementimi, që prej analizës dhe dizenjimit të kërkesave, parametrizimeve dhe konfigurimeve të sistemit, testimit, trajnimit dhe dokumentimit të projektit. 1 (një) punonjës i certifikuar për Menaxhim Projektesh, duke marrë parasysh kompleksitetin e projektit, afatet kohore të kryerjes së shërbimit, shumëllojshmërinë e shërbimeve të kërkuara, do të siguronte që çdo pike/komponent ishërbimeve të kërkuara të kryhen me sukses dhe cilësi si edhe në kohë e afat sipas përcaktimeve të dokumentave të tenderit.

Argumentimi për kërkesën: Të paktën 1 (një) punonjës të certifikuar në PHP/Java ose ekuivalente.

Kompetencat e specialistëve të certifikuar në PHP/Java ose ekuivalente , lidhen me nivelin e zotërimit të aftësive teknike, ekspertizën dhe njohuritë e nevojshme për të kryer role komplekse për zhvillimet e sistemeve informatike. Kërkesa për 1 (një) punonjës të certifikuar në php/java ose ekuivalente është e lidhur ngushtësisht dhe drejtpërdrejt me sistemin që kërkohet të realizohet, objekt kontrate. 1 (një) punonjës i certifikuar në php/java ose ekuivalente, i provon AK se Operatori Ekonomik ka në përbërjen e tij staf të aftë në krijimin dhe zhvillimin e sistemeve informatike dhe përmbushjen e detyrave të kërkuara, konkretisht me zërat :

- Implementimi i një sistemi për digjitalizimin, përpunimin, organizimin dhe indeksimin e dokumentëve shkresorë duke siguruar një kopje identike, elektronike të dokumentave zyrtarë fizike (letër).
- Periudha e mirëmbajtjes së sistemit me komponentët hardware dhe software.

Duke qene se kërkohet jo vetëm ndërtimi i një sistemi informatik por dhe mirëmbajtja e tij, për të garantuar vijueshmërinë e funksioneve dhe mirëmbajtjen e të gjithë komponentëve përbërës, është i nevojshëm dhe i domosdoshëm punonjësi i kërkuar.

Referuar termave të referencës, specifkimeve teknike, natyrës dhe objektit të saj, si dhe shërbimeve të kërkuara nga ana e autoritetit kontraktor, shfaqet e nevojshme zotërimi i stafit me kompetencat në PHP/Java ose ekuivalente.

Argumentimi për kërkesën: Të paktën 1 (një) punonjës të certifikuar për administrimin e bazës së të dhënave.

Nëpërmjet këtij kriteri, Autoriteti Kontraktor kërkon të garantojë që Operatori Ekonomik ofertues është i aftë për krijimin dhe administrimin e databazës dhe mirëmbajtjen eficiente të saj përgjatë periudhës së kërkuar sipas termave të referencës.

Mënyra më e saktë dhe që paraqet më pak risk për konfirmimin e aftësive të stafit është pajisja me certifikata, dhe paraqitja e tyre si dëshmi kualifikimi. Prania e tyre jep garanci për implementimin e detyrave të kontratës bashkë me shërbimet e mirëmbajtjes 24 mujore dhe operimin e sigurt me elementët përbërës të databazës.

Argumentimi për kërkesën: Të paktën 1 (një) punonjës të certifikuar për Testim Programesh ose ekuivalente.

Kualifikimet teknike të kërkuara nga Autoriteti Kontraktor janë të domosdoshme për të garantuar një implementim e testim cilësor dhe dokumentimin përfundimtar të rezultateve të kërkuara dhe proceseve të punës të cilat kërkohen të digjitalizohen. Këto kritere janë vendosur për të garantuar njohuri të plotë teknike të ofertuesve mbi sistemin e propozuar në çdo nivel të tij, si në nivelin teknik ashtu dhe në përdorimin e tij. Një ndër detyrat specifike, objekt kontrate përfshin dhe testimin e proceseve të implementuara si:

... “ **FAZA IV: Testimi**

- *Instalim i sistemit në versionin test.*
- *Vendosja e qëllimit të testimit, të dhënat hyrëse, proceset për t’u zhvilluar.*
- *Testimi i sistemit.*
- *Identifikimi i problemeve, raportimi pranë stafit përgjegjës të OE (nëpërmjet komunikimit verbal apo email) dhe zgjidhja e tyre.*
- *Ritestim i proceseve të ndryshuara.*
- *Dokumentimi përfundimtar i rezultateve të tij, nëpërmjet raportit të testeve që do ti dorëzohet komisionit të AK.*

... ”

Kërkesa për të paktën 1 (një) punonjës të certifikuar për Testim Programesh ose ekuivalente është e lidhur me realizimin e detyrave të sipërcituara, duke siguruar që çdo proces është në përputhje me kërkesat e autoritetit kontraktor.

Autoriteti Kontraktor, si përfituesi direkt i këtij investimi, kërkon dhe argumenton se, informacioni që do të ruhet në sistemin që do të ndërtohet është i një rëndësie të veçantë për të dhe nuk mund të tolerojë gabime, probleme sigurie apo mos funksionimin e sistemit sipas kërkesave të AK.

Gjithashtu kjo kërkesë i jep garanci autoritetit kontraktor për përmbushjen e kërkesave teknike referuar termave të referencës dhe specifikimeve teknike ku nevojiten të realizohen edhe

aktivitetet e testimit që kanë të bëjnë më çështjet e mirëmbajtjes për të garantuar shërbimin sipas marrëveshjes SLA.

Sa më sipër, është e nevojshme dhe e domosdoshme që proceset e zhvilluara dhe ndryshimet në rast se do të lind nevoja përgjatë periudhës së mirëmbajtjes, t'i nënshtrohen një procesi të testimit në mënyrë që të eliminohen të metat/erret në sistem. Për këtë arsye shërbimi i testimit duhet të udhëhiqet nga një specialist i cili zotëron kapacitetet dhe kualifikimin e nevojshëm për realizimin e tyre, duke garantuar mbarëvajtjen e sistemit me të gjithë komponentët përbërës dhe rrjedhimisht të kontratës.

Argumentimi për kërkesat:

Të paktën 1 (një) punonjës të certifikuar për konfigurimin e pajisjes *Server* të ofertuar.

Të paktën 1 (një) punonjës të certifikuar për konfigurimin e pajisjes *Upgrade Hapësirë ruajtëse* të ofertuar.

Kërkesa e autoritetit kontraktor për specialist të certifikuar për konfigurimin e pajisjes *Server* dhe *Upgrade Hapësirë ruajtëse* të ofertuar/ekuivalente, është e bazuar dhe e lidhur me instalimet dhe konfigurimet që nevojiten të kryhen nga specialistë të certifikuar për teknologjinë e ofertuar.

Për realizimin e konfigurimeve të kërkuara, është e domosdoshme dhe e nevojshme prania e specialistëve që njohin teknologjinë respektive të pajisjes, për të realizuar me sukses dhe në kohë instalimet dhe konfigurimet sipas kërkesave të AK.

Kriteret e vendosura për zërat e ofertuar si më sipër, garantojnë AK për kapacitetet dhe burimet njerëzore të ofertuesit për implementimin e kontratës me profesionalizëm dhe në afat.

Gjithashtu në specifikimet teknike të publikuara bashkëlidhur dokumentave të tenderit për këtë procedurë prokurimi, autoriteti kontraktor ka parashikuar mirëmbajtje të pajisjeve HW si dhe garanci respektive:

“Periudha e mbulimit të garancisë”, min 3 vjet për pajisjen *Server*,

“Operatori duhet të sigurojë gjithashtu një vit garanci shtesë për të gjithë pajisjen (ekzistuese Plus shtesën)” për pajisjen *Upgrade Hapësirë ruajtëse*.

Si rrjedhojë e sa më sipër, shfaqet e nevojshme disponueshmëria e stafit teknik të kualifikuar, në lidhje me identifikimin dhe riparimin e problemeve (nëse do të ketë) dhe kërkesa e autoritetit kontraktor në lidhje me stafin e kualifikuar është një kërkesë e përshtatshme për realizimin e një kontrate të sukseshme, duke arritur kështu synimin e kërkuar.

Argumentimi për kërkesën: Të paktën 1 (një) punonjës për MCSE Infrastrukturë ose ekuivalente.

Autoriteti kontraktor ka vendosur kërkesën për të paktën 1 (një) punonjës për MCSE Infrastrukture ose ekuivalente, e cila është në përpjestim dhe e lidhur ngushtë me natyrën dhe objektin e prokurimit. Në kërkesat e autoritetit kontraktor, pjesë e termave të referencës dhe specifikimeve teknike, objekt kontrate, kërkohet jo vetëm furnizimi i pajisjeve, por kërkohet gjithashtu të realizohen edhe instalimet, konfigurimet dhe integrimet respektive në infrastrukturën e Autoritetit Kontraktor.

Referuar sa më sipër cituar, kërkesa për të disponuar të paktën 1 (një) punonjës për MCSE Infrastrukturë ose ekuivalente, garantojnë autoritetin kontraktor se operatori ekonomik ofertues, ka aftësitë e nevojshme teknike për të instaluar, konfiguruar dhe integruar me infrastrukturën ekzistuese, me sukses pajisjet e ofertuara sipas kërkesave të autoritetit si dhe për të ofruar suportin e duhur përgjatë periudhës së parashikuar të mirëmbajtjes.

Argumentimi për kërkesën: 1 (një) punonjës, i certifikuar për ITIL ose ekuivalente.

Një certifikim ITIL është një set praktikash dhe kuadri rregullash dhe idesh për realizimin e shërbimit në teknologjinë e informacionit dhe komunikimit, që është komponent kryesor i projektit të Autoritetit Kontraktor. Kërkesa për certifikim ITIL ose ekuivalente, i dëshmon autoritetit që operatori ekonomik, nëpërmjet stafit të certifikuar si më sipër, garanton ideimin dhe konceptimin e shërbimeve IT të kontratës në mënyrë të menaxhueshme sipas standardeve ndërkombëtare të njohura, në gjithë ciklin e tyre, përfshirë këtu dhe shërbimet e mirëmbajtjes.

Argumentimi i specifikimeve teknike

Specifikimet teknike janë hartuar nga struktura të specializuara/ Grup pune për objektin që prokurohet, i ngritur me Urdhër të Titullarit për hartimin e specifikimeve teknike/ termave të referencave, në përputhje me parashikimet e nenit 4, pika 38/b dhe nenit 36, të LPP, si dhe nenit 41, pika 1, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021, “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, **duke argumentuar çdo kërkesë funksionale ose performance, apo/dhe çdo standard të kërkuar**, ku çdo referencë duhet të shoqërohet nga fjalët “ose ekuivalenti i tij/saj”.

Objektivi i përgjithshëm i projektit:

- Implementimi i një sistemi për digjitalizimin, përpunimin, organizimin dhe indeksimin e dokumentëve shkresorë duke siguruar një kopje identike, elektronike të dokumentave zyrtarë fizike (letër).

Ky projekt ka për qëllim krijimin e një sistemi elektronik i cili do të mundësojë:

- Konvertimin dhe ruajtjen e dokumentave të institucionit nga formati zyrtar (letër) në format digjital.
- Menaxhim në mënyrë eficiente të dokumentave. Dokumentat e digjitalizuar dhe indeksuar duhet të kalojnë në mënyrë automatike në sistem, të ruhen në hapësirën digjitale përkatëse, ku më pas përdorimi i tyre mund të gjurmohet, dokumentohet, menaxhohet dhe riprodhohet.
- Gjetje të dokumentit të duhur në formën më të shpejtë dhe më të lehtë. Dokumentat të cilat përmbajnë fjalë kyçe të përshtatshme në tekstin e tyre ose që kanë informacionin e duhur në meta-data (të dhënat përshkruese të dokumentit) mund të identifikohen dhe të gjenden lehtësisht.

- Aksesimi i dokumentave në çdo kohë. Dokumentat digjitale mund të thërriten elektronikisht nga cdo ambient ruajtjeje dhe mund të ndahen lehtësisht më pas me email apo në ndonjë formë tjetër, duke zëvendësuar kështu kopjen fizike të tyre në kopje identike digjitale dhe duke kursyer kohën që do të merrte procesi i kërkimit fizik në arkivën voluminoze të institucionit dhe fotokopjimit.
- Përmirësimi i efikasitetit dhe i efektivitetit në punë të kapitalit njerëzor të Bashkisë së Tiranës dhe dhënies së shërbimit në një kohë sa më të shpejtë .
- Rritja e sigurisë së dokumentacionit nëpërmjet krijimit të një kopje identike me origjinalin (kopjen fizike).

Termat e referencës dhe kërkesat funksionale janë hartuar në përputhje me parashikimet e nenit 4, pika 38/b dhe nenit 36, të LPP, si dhe nenit 41, pika 1, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021, “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”. me qëllim përmbushjen e objektivave të kontratës, qëllimit dhe rezultateve që pritet të arrihen nga Autoriteti Kontraktor.

INFRASTRUKTURA HARDWARE

1. SERVER

KARAKTERISTIKA MINIMALE TEKNIKE	
Modeli	I montueshëm në rack, min. 1U
Processor cores	minimum 16 kore fizike, 2.1 GHz, min 25000
Nr. Procesorëve	2
Memorje / RAM	Min 2x16 GB DDR4 2933MT/s reg ECC + 8x32GB DDR4 2933MT/s reg ECC – e shtueshme deri në të paktën 10 TB, 24 slotë. Support për SDDC dhe rank sparing.
Storage	2xSSD 240GB Mixed-Use 2.5” Hot Plug, suport deri në 8 disqe
RAID Kontroller	SAS/SATA RAID kontroller me support për RAID 0, 1, 10, 5, 50 për SSD dhe HDD
Rrjet	Minimum 4x1GB/s porta Ethernet. <i>Të instalohet, konfigurohet, dhe integrohet me të gjithë infrastrukturën egzistuese aktuale</i>
HBA	Minimumi 2 porta fiber për lidhje me infrastrukturën SAN storage, min 16 Gbps duke përfshirë kabëll FC OM4, 5m.

Power supplies dhe Ftohje	Redundant power supplies, minimum 900W për modul, 94% eficence.
PCIe	Minimum 4 slote PCIe 4.0 të përfshira në sistem
Portë Menaxhimi	Kontroller menaxhimi në remote me porte ethernet 1Gb/s e dedikuar.
Portë Komunikimi	Të përfshijë funksionalitet të plotë KVM në Porta VGA përpara dhe mbrapa.
Drive optik	DVD-ROM
Siguria	TPM 2.0 dhe suport për temperaturë 5-35°C
OS të suportuar	Windows Server 2022, 2019, VMware vSphere 6.7, 7
GARANCIA	
Periudha e mbulimit të garancisë	3 vjet

Ne kete server fizik do te ngrihen 6 makina virtuale, dy per aplikacionin dhe 4 servera per databazen. Keto 6 servera do te jene ne replikim te njera-tjetres. Serverat virtuale do te perdorin 32 – 64 GB RAM dhe 8 -18 core secili.]

Serveri do te integrohet ne infrastrukturen ekzistuese te Bashkise Tirane. Per kete arsye eshte kerkuar me 4 porta rrjeti RJ45 dhe 2 porta fiber me qellim qe te lidhet me SAN Switch.

Keta servera do ti shtohen sistemit ekzistues vCenter 7.0 ose HyperV qe jane aktualisht te ngritura ne Bashkine e Tiranës

- **UPGRADE HAPËSIRË RUAJTËSE**

Bashkia Tiranë disponon një pajisje Storage FAS2650 të konfiguruar në infrastrukturën e saj. Për të mundësuar rritjen e kapaciteteve të nevojshme për të ruajtur dhe menaxhuar të dhënat e sistemit, nëpërmjet këtij projekti, nevojitet rritja e kapacitetit dhe hapësirës së dedikuar të pajisjes ekzistuese.

Për këtë kërkohet të realizohet i furnizimi dhe instalimi i disk shelf dhe hard disqeve shtesë të cilat duhet të inkorporohen dhe të jenë plotësisht kompatibël me pajisjen ekzistuese storage FAS2650. Operatori Ekonomik duhet të ofrojë të gjithë aksesoret, komponentët, dhe licencat e nevojshme për të paktën 24 x 1.8TB SAS 10k rpm. Të gjithë disqet duhet të jenë hot-pluggable. Operatori duhet të sigurojë gjithashtu një vit garanci shtesë për të gjithë pajisjen (ekzistuese Plus shtesën).

Hapesira shtese kerkohet per te suportuar databazen e ketij sistemi. Ky sistem do te mbaje te gjithë Arkiven e Bashkise Tirane dhe si e tille kerkohet qe hapësira te jete mjaftueshem e madhe. I gjithë Storage do te jete ne RAID 1 (qe sjell pergjysmim te hapësires totale). Gjithashtu duhet te lihet dhe hapësira per Fail Over si dhe hapësire per backup ne rast problemi me kete server. Storage do te lidhet me Controller te SAN Storage.

- **SKANER FOTOGRAFIK**

Për të mundësuar skanimin e dokumentacionit të dëmtuar, nëpërmjet këtij projekti, duhet të lëvrohet edhe pajisja skaner fotografik me karakteristikat:

KARAKTERISTIKA MINIMALE TEKNIKE	
Tipi “Type”:	Over Head, Simplex ose Ekuivalente
Formati “Format”:	A3
Optical Resolution:	286 to 218 dpi (Horizontal scanning), 285 to 152 dpi (Vertical scanning)
Image Sensor	Lens reduction optics / Color CCD x 1
Light Source	(White LED + Lens illumination) x 2
Paper Weight (Thickness)	Min.30 mm
Shpejtësia e Skanimit “Scanning Speed”:	3 second/page (300 dpi) monochrome
Ushqimi “Power Supply”:	220 V AC, 50 Hz
KOMUNIKIMI & MENAXHIMI	
Porta e Komunikimit “Interface”:	High-Speed USB 2.0
Kompatibël me Sistemin e Operimit” Compatible O.S.”:	Win. 7 ose më lart
“Drivers” + OCR Software:	Po
AKSESORËT	

Ushqyes + Kabëll “Power Supply + Cord”:	Po, European
CD/DVD Drivers and Software:	Po
Kabëll për Komunikimin e të Dhënave “Data Cable”:	(1) USB Cable
GARANCIA	
Periudha e Mbulimit të Garancisë “Warranty”:	1 Vit

Skeneri kerkohet te skanoje deri ri ne format A3 pasi ne arkiven e institucionit ka nje sasi te konsiderueshme dokumentacioni te ketij formati. Kerkohet qe ky skaner te kete nje shpejtesi relativisht te larte skanimi, si pasoje e numrit shume te madh te dokumentacionit qe do te skanohet.

Në përfundim, Njësia e Prokurimit vendosi unanimisht miratimin e dokumenteve të tenderit. Për të krijuar dosjen e tenderit në sistemin e prokurimit elektronik të APP dhe për të ngarkuar të gjithë dokumentacionin e procedurës së prokurimit me objekt **“Sistemi elektronik për të ruajtur , menaxhuar dhe ndjekur në formë elektronike informacionin e bazuar në dokumenta zyrtarë(letër)”** , Njësia e Prokurimit autorizoi personin përgjegjës për prokurim.

Bashkëlidhur këtij procesverbali:

- *Dokumentat e tenderit*
- *Termet e referencës/ specifikimet teknike*